


OLIMPIADA MATEMATIKE E KOSOVËS 2026

KLASA IX - ZGJIDHJET

18 JANAR 2026


1. Tabela me dimensione 6×6 e përbërë nga katrorë njësi duhet të mbulohet përmes pllakave drejtkëndëshe, brinjët e të cilave përputhen me vijat e tabelës. Pllakat e ndryshme nuk mund të vendosen mbi njëra-tjetrën dhe duhet të kenë syprina të ndryshme. Sa pllaka mund të përdoren më së shumti?



Zgjidhje 1. Tabela ka syprinë 36. Nëse përdorim 9 ose më shumë pllaka, meqë ato duhet të kenë syprina të ndryshme, atëherë syprina totale e tyre do të jetë të paktën $1 + 2 + 3 + \dots + 9 = 45 > 36$.

Nëse përdorim 8 pllaka, atëherë syprina minimale e tyre do të jetë $1 + 2 + 3 + \dots + 8 = 36$. Atëherë duhet të kemi nga një pllakë me secilin nga këto syprina. Por, pllaka me syprinë 7 mund t'i ketë dimensionet vetëm 1×7 ose 7×1 dhe si e tillë nuk mund të vendoset brenda tabelës me dimensione 6×6 .

Me 7 pllaka ekziston një mbulim i tabelës në këtë mënyrë:



2. Le të jenë a, b, c, d, e numra natyrorë të tillë që $\text{pmmp}(a, b, c, d, e) > 1$. Prodhimi i tyre është numër çift ndërsa shuma e tyre është numër tek. Sa është vlera më e vogël e mundshme e shprehjes $a + b + c + d + e$?

Shënim. $\text{pmmp}(a, b, c, d, e)$ është numri më i madh natyror i cili është pjesëtues i të gjithë numrave a, b, c, d, e .

Zgjidhje. Vërejmë se njëri nga numrat duhet të jetë çift pasi që prodhimi është çift. Pasi që shuma e numrave është tek, atëherë numri i numrave çift duhet të jetë çift. Kjo i bie që të paktën dy nga numrat janë çift. Tani, $\text{pmmp}(a, b, c, d, e)$ nuk mund të jetë 2 pasi atëherë të gjithë numrat do të ishin çift dhe shuma e tyre do të ishte çift. Pra, $\text{pmmp}(a, b, c, d, e) \geq 3$. Në mënyrë që të shuma $a + b + c + d + e$ të jetë sa më e vogël, marrim dy raste:

- $a = b = c = 3$ dhe $d = e = 6$. Në këtë rast kemi $a + b + c + d + e = 3 + 3 + 3 + 6 + 6 = 21$.
- $a = 3$ dhe $b = c = d = e = 6$ që qartazi e ka shumën më të madhe se 21.

Përfundojmë që shuma më e vogël e numrave është 21.

3. Le të jetë $ABCD$ trapez me bazat AB dhe CD , ku këndi $\angle BDC$ është i ngushtë. Janë dhënë gjatësitë $AC = 20$, $BD = 15$ dhe lartësia e trapezit është 12. Tregoni që diagonalet e trapezit janë normale (pingule) ndaj njëra-tjetrës.


Zgjidhje. Le të jenë X dhe Y këmbëzat e lartësive prej A dhe B në CD . Qartazi $AX = BY = 12$. Nga Teorema e Pitagorës në $\triangle AXC$ dhe $\triangle BYD$ kemi që $CX = \sqrt{20^2 - 12^2} = 16$ dhe $DY = \sqrt{15^2 - 12^2} = 9$. Tani vërejmë se

$$\frac{9}{12} = \frac{12}{16} = \frac{15}{20} \iff \frac{DY}{AX} = \frac{BY}{CX} = \frac{BD}{AC} \Rightarrow \triangle AXC \sim \triangle DYB$$

nga kriteri BBB. Le të jetë P pikëprerja e AC dhe BD . Duke shfrytëzuar ngjashmërinë kemi

$$\angle CPD = 180^\circ - \angle PCD - \angle PDC = 180^\circ - \angle PCD - \angle CAX = 180^\circ - 90^\circ = 90^\circ,$$

çka duhej vërtetuar.



4. Le të jenë a, b numra realë pozitivë. Tregoni që

$$\frac{a^2}{4b} + \frac{b^2}{4a} \geq \frac{a^2 + b^2}{(a+1)(b+1)}.$$

Zgjidhje 1. Kemi

$$\frac{a^2}{4b} + \frac{b^2}{4a} = \frac{a^3 + b^3}{4ab}.$$

Nga jobarazimi i Koshi-Shvarcit, kemi

$$(a^3 + b^3)(a + b) \geq (a^2 + b^2)^2,$$

prandaj

$$\frac{a^3 + b^3}{4ab} \geq \frac{(a^2 + b^2)^2}{4ab(a + b)}.$$

Kështu, mjafton të tregojmë që

$$\frac{a^2 + b^2}{4ab(a+b)} \geq \frac{1}{(a+1)(b+1)} \iff a^3b + b^3a + a^3 + b^3 + a^2 + b^2 \geq 3a^2b + 3b^2a.$$

Jobarazimi i fundit vlen pas mbledhjes së jobarazimeve

$$a^3b + a^3 + b^2 \geq 3a^2b, \quad b^3a + b^3 + a^2 \geq 3b^2a$$

që vlejnë nga jobarazimi AM-GM.

Zgjidhje 2. Duke shumëzuar jobarazimin me $4ab(a+1)(b+1)$ fitojmë jobarazimin ekuivalent

$$a^4b + a^4 + a^3b + a^3 + b^4a + b^4 + b^3a + b^3 \geq 4a^3b + 4ab^3. \quad (1)$$

Ky jobarazim vlen pas mbledhjes së jobarazimeve

$$a^4b + a^4 + b^3a + a^3 \geq 4a^3b, \quad b^4a + b^4 + a^3b + b^3 \geq 4b^3a,$$

që vlejnë nga jobarazimi AM-GM.

Shënim. Zgjidhja 2 duket më e thjeshtë, por është e rëndësishme që monomet a^3b dhe b^3a mos të zbriten nga të dyja anët e (1), pasi kjo e vështirëson përdorimin e jobarazimit AM-GM me 3 monome.